



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE MRBOJTJE DHE SHPËTIM

Data:	07.04.3026
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Sead Aliu – Drejtor i DSHPMSH-së
Lënda:	Raporti i muajit Mars 2026

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në bazë të përgjegjësisë dhe kompetencave të DSHPMSH-së gjatë muajit Mars 2026, DSHPMSH-ja ka kryer aktivitetet që ka pasur të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE

- Pranimi, evidentimi, zgjedhja dhe arkivimi i lëndëve të arritura nga qytetarët apo institucionet të tjera.
- Është bërë barazimi i të hyrave nga hapësirat publike, i fakturave të ndriqimit publik si dhe nga mirëmbajtja e tregjeve.
- Kërkesë Drejtoratit të Prokurimit për inicim të procedurës: Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë dhe një konsulent për menaxhimin e ujrave të zeza.
- Kërkesë Zyres së Personelit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për një zyrtar për transport
- Kërkesë Kryetarit të Komunës për formimin e grupeve punuese për hartimin e draft planeve komunale.
- Është punuar draft plani për transportin publik të udhëtarëve me autobus në Komunën e Lipjanit
- Janë dhënë pëlqime për: prerje të rrugëve për rehabilitimin e rrjetit të ujës-jellës në fshatin Ribar i Vogël dhe për vendosjen dhe zhvendosjen e shtyllave të tensionit të lart në vend të atyre të ultë.
- Janë përgatit paramasa nga menaxherët.
- Është intervenuar në eliminimin e prishjeve, ndërrimin e pajisjeve të djegura në ormanin e ndriqimit publik në Gadime e Epërme, në rrugën: “Haradin Bajrami” ,Shefki Salih i në Lipjan në disa rrugica në fshatin Dobrajë Madhe, Krojmir, Magurë, Hallaq i Vogël. Është bërë dislokimi dhe vendosja e shtyllës së ndriqimit publik në objektin e xhamisë në fshatin Torinë. Kemi filluar me vendosjen e shtyllave të riparuar pas aksidenteve në rrugën “Avdi Kelmendi” në Lipjan, si dhe është bërë dislokimi i rrjetit të ndriqimit publik nga shtyllat e drurit në shtyllat e betonit në disa rrugica të fshatit Shalë.

- Janë bërë intervenime në sanimin e rrjetit të kanalizimit për (debllokim) në: Në qytetin e Lipjanit, në fshatin Llugaxhi te shkolla në Gadime te shkolla, “Zenel Hajdini”, Mirenë, Poturoc si dhe në Gadime të Ultë.

Mbikqyrja e kontratave kornizë:

- Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera publike në qytetin e Lipjanit.
- Menaxhimi i tregjeve te Lipjanit
- Mirëmbajtja e ndriqimit publik në qytet dhe në fshatra.
- Hapja - pastrimi i lumenjëve, mirëmbajtja e varrezave dhe mirëmbajtja e hapësirave publike në teritorin e Komunës së Lipjanit.
- Mirembajtja e rrjeteve të kanalizimit në qytet dhe fshatra.
- Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror sipas lotove.
- Shërbimet me internet Wi FI në hapësirat publike të qytetit
- Mirëmbajtja e paisjeve sinjalizuese, kamerave, zërimit dhe paisjeve tjera.
- Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor

Puna me palë dhe punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve

STATISTIKAT

Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHPMSH-së

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
57	42		8	7

Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHPMSH-së

Pasqyra e aktiviteteve të DSHPMSH-së		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr.
1	Kërkesa, njoftime, pëlqime, përgjigje si dhe shkresa te ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	31
2	Përgatitja e paramasave dhe parallogarive	2
3	Takime zyrtare në Ministri, KEDS AME dhe institucione tjera	3
4	Vizita në teren	70
5	Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme	1
6	Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve	0

